



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

**NJOFTIM**

Njoftohen të gjithë prokurorët e emëruar në Prokurorinë e Posaçme të shprehin interesin për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

Shprehja e interesit duhet të shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

- Letra e motivimit (1-2 faqe A4) në të cilët të shprehet motivimi juaj për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.
- Një letër mbështetëse (shpjeguese) për standardet 1,2,3,4,5,7 të parashikuar në metodologjinë e miratuar me vendim të KLP nr.237, datë 25.11.2019 (publikuar në faqen zyrtare të Këshillit)
- Vizioni ose plani i besueshëm për ndërtimin e Prokurorisë së Posaçme si një institucion funksional dhe efektiv sipas standardit 6 të metodologjisë (një dokument deri në 5 faqe A4 të shkruara me shkrim 12 në llojin Times Neë Roman)
- Dokumente të tjera për të dëshmuar përmbushjen e standardeve të përcaktuara në metodologji si më poshtë:
  - Për standardin 1 nuk ka nevojë për dokumentacion shtesë. Në letrën mbështetëse, kandidatët duhet të listojnë çështjet e vlerësuara në fazën e parë dhe të nënvizojnë dy prej tyre, duke shpjeguar rëndësinë dhe lidhjen me pozicionin për të cilin aplikojnë.
  - Për standardin 2, përveç letrës mbështetëse, kandidatët duhet të paraqesin jo më shumë se dy dokumente për të dëshmuar aftësinë e tyre lidhur me Eksperiencën drejtuese e vendimmarrëse e kandidatit në të kaluarën;  
Nivelin në të cilin kandidati i ka ushtruar kompetencat vendimmarrëse e drejtuese;  
Rezultatet e arritura në drejtim/menaxhim.
  - Për standardin 3, kandidatët duhet të paraqesin letrën shpjeguese si dhe jo më shumë se dy dokumente që vërtetojnë pjesëmarrjen e tyre në grupe pune për hartimin dhe miratimin e rregulloreve të ndryshme apo akteve të tjera me karakter administrative.

- Për standardin 4 kandidatët duhet të paraqesin letrën mbështetëse dhe si dokumentacion provues, veç të tjerash, edhe publikimet e ndryshme në media për çështje të hetuara apo përfaqësuara prej tyre të cilat kanë tërhequr vëmendjen e publikut dhe medias (në çdo rast jo më shumë se dy dokumente).
- Për standardin 5 kandidatët mund të dorëzojnë të njëjtin dokumentacion si për standardin 2 i cili vlerëson eksperiencat në drejtimin e një strukture, ku përfshihet edhe menaxhimi efektiv i burimeve njerëzore. Kandidatët duhet të theksojnë që dokumentacioni i dorëzuar shërben për vlerësimin e dy standardeve. Në letrën shpjeguese kandidatët duhet të sqarojnë aftësitë e tyre lidhur me këtë kriter si dhe ta mbështesin këtë letër me të paktën dy dokumente shtesë.
- Për standardin 6, siç u theksua më sipër nevojitet vetëm një dokument deri në 5 faqe A4 ku të prezantohet vizioni ose plani i besueshëm për ndërtimin e Prokurorisë së Posaçme si një institucion funksional dhe efektiv
- Për standardin 7, përveç letrës shpjeguese, lidhur me përmbushjen e këtij standardi, kandidatët mund të paraqesin çdo dokument i cili i shërben vlerësimit të imazhit të tyre si prokurorë, përfshi këtu edhe pjesë të vendimeve të organeve të rivlerësimit, vlerësime nga ana e eprorëve të tyre, vlerësime nga institucione apo organizata të ndryshme vendase apo të huaja etj.

Dorëzimi i kërkesës dhe dokumentacionit do të bëhet pranë zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në adresën: Rruga “Qemal Stafa”, nr.1, pranë mjediseve të Prokurorisë së Përgjithshme, Tiranë.

Afati i aplikimit është data 10 dhjetor 2019.

**Tiranë, më 26.11.2019**